



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës  
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosovo  
Civil Aviation Authority of Kosovo

Nr. 11/ZDP/VE/2016  
Datë: 30 dhjetor 2016

Në mbështetje të nenit 14.1, 14.2, 15.1(f), 21.2 dhe 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, 4 qershor 2008), nenit 15 të Rregullores së AAC-së nr. 3/2016 mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, datë 10 shkurt 2016 ("Rregullorja") dhe nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, 28 prill 2014),

Duke vendosur sipas riaplikimit të Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror ("ASHNA"), nr. prot. 0106, dt. 23 dhjetor 2016, për tarifën njësi terminale për vitin 2017,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

### VENDIM

1. Përcaktohet tarifa njësi terminale 2017 në Republikën e Kosovës në vlerë prej 346 (treqind e dyzet e gjashtë) EUR. Kjo tarifë u ngarkohet kompanive ajrore nga ASHNA për shërbimet terminale të navigacionit ajror që ofron në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës (Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari") duke filluar nga data 1 janar 2017.
2. ASHNA obligohet që të inicojë amandamentimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me LIMAK Kosovo International Airport mbi mbledhjen dhe depozitimin e tarifave të ASHNA-s, të nënshkruar në maj 2011.
3. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

### ARSYETIM

Sipas Rregullores, AAC-ja ka të drejtë që të shqyrtojë dokumentet përkatëse të kontabilitetit, librat e aseteve, inventarët dhe çfarëdo materiali tjetër përkatës në caktimin e tarifave të navigacionit ajror.

Me qëllim të vlerësimit të aplikacionit të ASHNA-s për përcaktimin e tarifës njësi terminale për vitin 2017, AAC-ja ka marrë parasysh dokumentet dhe informatat në vijim:

- Informatat dhe dokumentet e paraqitura nga ASHNA gjatë raportimit të tyre të parë (baza fillestare e kostove përmes përdorimit të Tabelave të Raportimit nga Shtojca II dhe VI e Rregullores), të dorëzuara më 31 mars 2016, në pajtim me nenin 15 të Rregullores;
- Informatat dhe dokumentet e paraqitura nga ASHNA gjatë raportimit të tyre të dytë (baza përfundimtare e kostove përmes përdorimit të Tabelave të Raportimit nga Shtojca II dhe VI e Rregullores), më 8 shtator 2016, të dorëzuara me vonesë dhe pas dorëzimit të kërkesës buxhetore në Ministrinë e Financave në kundërshtim me nenin 15 të Rregullores, përkundër kërkesës së datës 25 gusht nga AAC-ja për raportim jo më larg se deri më 31 gusht;
- Informatat dhe dokumentet e paraqitura nga ASHNA më 29 shtator 2016 për qëllime të Planit Fillestar të Performancës;
- Pasqyrat e audituara financiare të Kontrollit Ajror - Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" sh.a. për vitin financiar të përmbyllur më 31 dhjetor 2015;
- Informatat dhe dokumentacioni të siguruara nga disa takime të mbajtura ndërmjet ASHNA-s dhe AAC-së si dhe komunikimi elektronik me qëllim të përcaktimit të tarifës njësi terminale për vitin 2017;
- "Raportin për përcaktimin e tarifës njësi terminale për vitin 2017 - Kosovë", të publikuar nga AAC-ja, i cili iu është vënë në dispozicion për konsultim publik kompanive ajrore prej 9 deri më 30 nëntor 2016;
- Raportin mbi konsultimin publik të palëve të interesit nr. 3/2016, publikuar nga AAC-ja më 6 dhjetor 2016;
- Vendimin nr. 10/ZDP/VE/2016 të datës 16 dhjetor që refuzon miratimin e tarifës njësi terminale në vlerë prej 396.23 Euro, siç ishte propozuar nga ASHNA më dt. 29 shtator 2016;
- Buxhetin e përcaktuar për ASHNA-n në bazë të Ligjit 05/L-125 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më dt. 23 dhjetor 2016;
- Riaplikimit të ASHNA-s për tarifën njësi terminale për vitin 2017, nr. prot. 0106, dt. 23 dhjetor 2016;
- Vendimit nr. 05-V-286, dt. 25 maj 2016 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përmes së cilit AAC-ja udhëzohet të ndër marrë masat e nevojshme nga fushëveprimi i vet për të krijuar një konkurrencë më të madhe në funksion të uljes së çmimeve të udhëtimit.



Duke u mbështetur mbi këtë bazë ligjore, Drejtori i përgjithshëm ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 30 dhjetor 2016

  
**Dritan Gjonbalaj**  
Drejtor i përgjithshëm



**Udhëzim mbi mjetin juridik:**

Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesë. Pala e pakënaqur mund të ngrisë padi për konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente 30 ditë nga pranimi i këtij Vendimi. Ngritja e padisë nuk e pezullon ekzekutimin e këtij Vendimi.

Iu dërgohet:

- Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror
- Ministrit të Infrastrukturës
- Komitetit të kompanive ajrore në ANP "Adem Jashari"
- Departamentit Qendror për Partneritet Publiko-Privat, Ministria e Financave
- Limak Kosovo International Airport J.S.C.